



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 655 Akti

Nr. 458 Vendimi
Tiranë, më 11.10.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datat 7.10.2021 dhe 11.10.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Albert Kuliçi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Albert Kuliçi, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Albert Kuliçi, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Albert Kuliçi do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLGj), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Albert Kuliçi, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Valbona Sanxhaktari. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti nuk u shpreh mbi ndonjë gjendje konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 21.9.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Albert Kuliçi dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 24.9.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se

data 4.10.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 4.10.2021, subjekti i rivlerësimit dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ kryesisht.

8. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 4.10.2021, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

9. Në datën 7.10.2021, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Albert Kuliçi, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në datën 24.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit

Albert Kuliçi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2010, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Albert Kuliçi, ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Albert Kuliçi, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

17. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

18. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Automjeti tip ‘Ford Focus’, blerë në muajin nëntor të vitit 2011 nga shtetasi B. B., në vlerën 1.000 euro. Pjesa në %: 100%. Burimi i krijimit: paratë për blerjen e këtij automjeti, janë siguruar nga të ardhurat e krijuara nga familja ime. Automjeti është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Durrës dhe mban targat ***”.

19. Gjatë hetimit administrativ DRSHTRR-ja¹ konfirmoi të regjistruar në emër të shtetasit Albert Kuliçi automjetin me targa ***, me nr. shasie ***, blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2011 dhe shitur prej tij në vitin 2019.

20. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë, nga aktet² në dosjen e ILDKPKI-së dhe në dokumentet e administruara nga DPSHTRR-ja, u konstatua se:

- sipas dokumentit certifikatë pronësie, nr. ***, të Komunës V., Itali, shtetasi B. B. është pronar i automjetit tip “Ford Focus”, prodhim i vitit 2000, me targa ***, me nr. shasie ***;

¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.1.2021, të DPRSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

²Shihni aktet në aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.1.2021, në dosjen e Komisionit.

- me deklaratën verbale të shitjes së datës 18.11.2011, shtetasi B. B. i shet subjektit Albert Kuliçi këtë automjet, në vlerën 1.000 euro. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar saktësisht këtë pasuri dhe burimin e krijimit përputhet me atë të deklaruar në deklaratën *Vetting*;
- sipas deklaratës doganore të datës 18.11.2011, Porti Durrës, është paguar detyrimi doganor në shumën 32.713 lekë, e cila është përfshirë si shpenzim në analizën financiare;
- automjeti është regjistruar në datën 21.11.201, në pronësi të subjektit Albert Kuliçi, i cili e ka shitur në çmimin 60.000 lekë, me kontratën e shitblerjes nr. *** regj., datë 9.5.2019;
- në lidhje me shtetasin B. B., pas verifikimeve të kryera, nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi³, apo përfshirje të tij në veprimtari të krimit të organizuar⁴.

21. Si burim i krijimit të automjetit janë deklaruar të ardhurat familjare. Nga analiza financiare e kryer bazuar në të ardhurat e dokumentuara, gjendjet e likuiditeteve, shpenzimet e jetesës dhe jo vetëm, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën në vijim, rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë këtë automjet në shumën 1.000 euro, si dhe për të kryer shpenzimet për zhdoganimin dhe regjistrimin e tij në shumën 97.713 lekë, në datën 18.11.2011.

Përshkrimi	18.11.2011
Pasuritë	355 248
Automjet tip "Ford Focus", ***, blerë në shumën 1.000 euro	138 930
<i>shtesa/pakësime likuiditetesh</i>	<i>216 318</i>
Gjendja e likuiditeteve	224 452
Të ardhurat	1 038 778
Të ardhura nga paga e subjektit	736 327
Të ardhura nga paga e bashkëjetueses	302 451
Shpenzimet	548 958
Shpenzime jetese	217 095
Shpenzime udhëtimi	69 150
Shpenzime qiraje	165 000
Shpenzime zhdoganimi dhe regjistrimi të automjetit	97 713
Mundësia për kursime	134 572

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u evidentuan problematika dhe dyshime në lidhje me këtë automjet.

22. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: "*Lekë në shumën 681.464,77, në llogarinë bankare nr. ***, në 'Intesa Sanpaolo Bank'. Pjesa në %: 100%. Burimi i krijimit të tyre: 393,750 lekë të fituara nga procesi gjyqësor i zhvilluar nga i ndjeri babai im ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes-Drejtoria e Zonës Durrësi, me padi pune (paga të cilat më janë dhënë mua nga trashëgimtarët e tjerë pa ndonjë akt të shkruar), si dhe 210.000 lekë të kursyera nga paga ime si prokuror, plus interesat bankare për tre vjet, sipas depozitës përkatëse bankare*".

³Shihni shkresat: kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 21.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

⁴Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.7.2021, nga SPAK, në dosjen e Komisionit.

Gjatë hetimit administrativ u vërtetua se:

22.1. Në DPV-në e vitit 2013, në rubrikën “ndryshimet e pasurive”, subjekti ka deklaruar:

*“Shumën prej 393.750 lekësh të fituara nga procesi gjyqësor i zhvilluar nga i ndjeri babai im ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes-Drejtoria e Zonës Durrës, me padi pune. Këto para janë depozituar në llogarinë time me numër ***, në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, të cilat më janë dhënë mua nga trashëgimtarët e tjerë. Pjesa në %:100 %.*

*Në datën 1.8.2013, shumën prej 200.000 lekësh të deklaruara për vitin 2012, të cilat kanë qenë cash në shtëpi, i kam depozituar në llogarinë nr. ***, në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, si dhe kam shtuar shumën 10.000 lekë, duke i bashkuar me shumën e mësipërme, kam krijuar depozitë me afat 3-vjeçar në shumën totale prej 602.800 lekësh. Pjesa takuese: 100%”.*

22.2. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë në “Intesa Sanpaolo Bank”⁵, rezultoi se:

- i) në llogarinë e subjektit në datën 31.1.2013, është kryer një transfertë në shumën 393.750 lekë, me përshkrimin “likuidim detyrimi, urdhërues ‘T. G.’ sh.p.k. dhe përfitues Albert A. Kuliçi, lagjja ‘H. C.’”;
- ii) në datën 1.8.2013, subjekti ka depozituar cash shumën 210.000 lekë me përshkrimin “kursime nga puna dhe familja”;
- iii) shuma e përftuar prej 602.800 lekësh është investuar në depozitë me afat 3-vjeçar dhe është maturuar në datën 3.8.2016. Së bashku me interesat e përfituara, gjendja në llogarinë bankare në datën e deklaratës *Vetting* është në shumën 681.464.77 lekë.

Deklarimet e subjektit përputhen me të dhënat bankare.

23. Në lidhje me burimin e krijimit të depozitës së çelur në datën 31.1.2013, në “Intesa Sanpaolo Bank”, nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së⁶, konstatohet se:

23.1. Sa i takon shumës prej 393.750 lekësh, u vërtetua që të jetë përfituar nga babai i subjektit A. K., me vendimin nr. ***, datë 14.6.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 12.6.2012, nga Gjykata e Apelit Tiranë shumë e cila i kaluar subjektit në bankë në datën 31.1.2013, vërtetuar me shkresën nr. *** prot., datë 2.2.2021, te “Intesa Sanpaolo Bank”.

Me vendimin nr. ***, datë 7.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është çelur dëshmia e trashëgimisë së trashëgimlënësit A. S. K., duke përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij: H. K. (bashkëshortja), M. K. (e bija), Albert Kuliçi (i biri), M. K. (e bija), R. K. (e bija), të cilët trashëgojnë 1/5 pjesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënësit.

Pavarësisht se sipas kësaj dëshmie, subjekti ka trashëguar vetëm 1/5 e shumës së përfituar me vendim gjykate prej 393.750 lekësh, në deklaratën *Vetting* e ka deklaruar këtë vlerë monetare 100% në pronësi të tij (vlerë të cilën e ka deklaruar si shtesë pasurie në DPV-në për vitin 2013), me sqarimin se pjesa takuese e trashëgimtareve i është dhënë atij prej tyre pa ndonjë akt shkresor. Me kërkesë të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka informuar se për shkak të

⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 2.2.2021, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁶Shihni aneksin 4/3 dhe 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

marrëdhënies së posaçme familjare, në atë periudhë nuk është nënshkruar ndonjë akt noterial që vërteton dhurimin dhe për të mbështetur këtë deklaram ka paraqitur katër deklarata noteriale, të cilat vërtetojnë vullnetin e trashëgimtarëve të tjerë ligjore të babait të tij, që shuma e lekëve të përfituara nga trashëgimlënësi i tyre A. K. nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 14.6.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, t'i kalonte subjektit dhe se ata nuk kanë pasur asnjë pretendim mbi këtë shumë. Nisur nga këto deklarime, si dhe nga fakti që subjekti e ka deklaruar shumën prej 393.750 lekësh, si shtesë likuiditeti që në DPV-në për vitin 2013, kjo shume është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të subjektit.

23.2. Sa i takon shumës 210.000 lekë, depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 1.8.2013, e ka burimin në gjendjen *cash* të deklaruar në DPV-në për vitin 2012, me burim *të kursyera nga paga si prokuror*. Këtë gjendje *cash* të krijuar gjatë vitit 2012, subjekti e ka deklaruar qartësisht se është përdorur për depozitën në “Intesa Sanpaolo Bank” edhe në DPV-në për vitin 2013 edhe në deklaratën *Vetting*. Subjekti ka pasur mundësi të krijojë gjendje *cash* në fund të vitit 2012, me burim kursimet nga paga, pasi analiza financiare e këtij vitit rezulton me balancë pozitive.

Në përfundim të hetimit administrativ, është vërtetuar burimi i ligjshëm i likuiditetit në vlerën prej 681.464,77 lekësh.

24. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura të pa tërhequra nga llogaria e pagës në ‘Credins Bank’ me nr. ***, në shumën 25, 378, 19 lekë. Pjesa në %: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga si prokuror”*.

Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në “Credins Bank”⁷, vërtetohet se deklarimi i subjektit është i saktë.

25. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *“Shpenzim në shumën prej 387,000 lekësh, para të cilat janë siguruar nga kursimet cash nga paga si prokuror. Kjo shumë është derdhur në datën 12.1.2017, në llogarinë e pagës së bashkëjetueses në ‘Tirana Bank’ në numër llogarie ***. Nga kjo shumë parash, shuma prej 386,262 lekësh është transferuar në por të njëjtën datë nga bashkëjetuesja për llogari të ‘H. H.’, Tiranë për shërbime mjekësore. Pjesa në %: 100 %”*.

Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në “Tirana Bank”⁸, vërtetohet se deklarimi i subjektit është i saktë. Subjekti e ka deklaruar këtë veprim edhe në DPV-në për vitin 2017, e cila është plotësuar përpara deklaratës *Vetting*, njësoj sikurse si në deklaratën *Vetting*. Ndërsa, nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore, rezultoi se subjekti në fund të vitit 2016 ka pasur gjendje *cash* shumën prej 400.000 lekësh, e cila ka shërbyer si burim për depozitim e shumës 387.000 lekë, në datën 12.1.2017, në ‘Tirana Bank’ Sa i takon mundësisë së subjektit për ta krijuar, ndër vite, këtë likuiditet në *cash* të mbartur deri në fund të vitit 2016, rezultoi se së bashku me bashkëjetuesen⁹, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, sikurse është treguar në tabelën përmbledhëse të analizës financiare.

⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2021, nga “Credins Bank”, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸Shihni shkresën nr.*** prot., datë 19.1.2021, nga “Tirana Bank”, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹Bashkëjetesa ka nisur në vitin 2011.

26. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Apartament me sip. 87 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në adresën lagjja ‘I. B.’, Vlorë në pronësi të shtetasit G. H., regjistruar në ZVRPP-në Vlorë. Mbi këtë pasuri gëzoj të drejtën e përdorimit si qiramarrës që prej datës 1.1.2012 dhe në vazhdim kundrejt pagesës së qirasë mujore në shumën prej 15.000 lekësh/muaj*”.

26.1. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se nuk ka një akt shkresor që të vërtetojë marrëdhënien e qiradhënies, por subjekti ka deklaruar në DPV këtë marrëdhënie qiraje, konkretisht:

- Në DPV-të për vitet 2011 dhe 2012, në rubrikën “detyrimet financiare”, subjekti ka deklaruar pagesë në shumën 15.000 lekë/muaj, për qira banese në Vlorë ndaj shtetasit G. A.. Subjekti ka sqaruar se pagesa bëhet parapagim, çdo fillim muaji.

- Në DPV-në për vitin 2013 nuk është deklaruar pagesë qiraje.

- Në DPV-në për vitin 2014, në rubrikën “detyrimet financiare”, subjekti ka deklaruar pagesë për qira në shumën 15.000 lekë/muaj dhe të shlyer të gjithë detyrimin në shumën 180.000 lekë.

- Në DPV-në për vitet 2015 dhe 2016, subjekti deklaroi se ka shlyer të gjithë detyrimin e qirasë për vitet 2015 dhe 2016 dhe se për vitin 2017 kontrata do të ripërtërihet.

- Në DPV-në për vitin 2017, subjekti ka deklaruar si adresë Zyra e Gjendjes Civile lagjja “D.”, rruga “J. D. R.”, p. ***, nd. ***, h. ***, ap. ***, Bashkia Vlorë, në të cilën ka filluar të banojë nga prilli i vitit 2017 (banesë e trajtuar në vijim), fakt që tregon që marrëdhënia e qirasë me shtetasin G. A. është zgjidhur, ashtu sikurse subjekti dhe ky shtetas deklarojnë.

26.2. Duke qenë se subjekti e ka përdorur këtë pasuri për periudhën 2012 – 2016, nga Komisioni janë kryer disa veprime hetimore, në përfundim të të cilave, rezultoi se:

- Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.1.2016¹⁰, shtetasi G. A. ka deklaruar se ka në pronësi një apartament me nr. pasurie ***, në Vlorë dhe në këtë apartament ka strehuar kundrejt një qiraje prej 15.000 lekë/muaj, për periudhën 2012 – 2016, shtetasin Albert Kuliçi. Bashkëngjitur ka paraqitur certifikatë për vërtetim pronësie, datë 16.5.2006.

- Nga verifikimi në sistemin *online* të ASHK-së rezultoi e regjistruar në pronësi të shtetasit G. A., vetëm pasuria nr. ***.

- Nga të dhënat e FSHU-së rezultoi se shtetasi G. A. ka lidhur kontratë për furnizimin me energji elektrike vetëm për këtë pasuri në Vlorë.

- Në lidhje me shtetasin G. A., nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi¹¹ apo përfshirje të tij në veprimtari të krimit të organizuar¹². Po kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë¹³ nuk ka konfirmuar procese gjyqësore penale apo civile në emër të këtij shtetasi.

- Në DPV, në rubrikën adresë vendbanimi për periudhën 2012 – 2016, subjekti ka deklaruar dy adresa: (i) *Vlorë, tek ‘B.’, pallati i vjetër pesëkatësh, kati i parë, hyrja ****; dhe (ii) *Lagjja ‘I.*

¹⁰Shihni aktet në aneksin 4/6 të dosjes së ILDKPKI-së.

¹¹Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 21.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

¹²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.7.2021, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

¹³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 6.8.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

B.", rruga "S. Z.", Vlorë, për të cilat gjatë procesit të rivlerësimit deklaroi se i përkasin të njëjtës banesë të dhënë me qira nga shtetasi G. A.. Nga të dhënat e ditura publikisht lagjja "I. B.", rruga "S. Z., në Vlorë, ndodhet në zonën e quajtur ndryshe "B.", pra, këto dy adresa i përkasin së njëjtës pasuri të dhënë me qira nga shtetasi G. A..

26.3. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me konstatimet si vijojnë:

i) marrëdhënia e qirasë, për periudhën 2012 – 2016, mes subjektit dhe shtetasit G. A. është deklaruar në DPV, por nuk është një marrëdhënie e formalizuar me akt shkresor, sikurse parashikon neni 803 i Kodit Civil;

ii) në DPV-në për vitin 2013, subjekti nuk ka kryer deklarime në lidhje me marrëdhënien e qirasë;

iii) në kushtet kur nga hetimi administrativ nuk rezultuan pasuri të tjera të regjistruara në pronësi të shtetasit G. A. dhe as kontrata të tjera të furnizimit me energji elektrike, mbetet e paqartë se ku ka banuar z. G. A. gjatë periudhës që këtë pasuri ia ka dhënë me qira subjektit të rivlerësimit.

26.4. Në parashtrimet e tij të datës 4.10.2021, në lidhje me këto konstatime, subjekti ka parashtruar:

Së pari, mosformalizimi i kontratës së qirasë me shkrim ka qenë për arsye të pasigurisë së qëndrimit në këtë banesë, duke mbajtur parasysh funksionin e prokurorit dhe mënyrën e organizimit të sistemit, e cila nuk e lejonte të përcaktonte periudhën kohore që do t'i duhej të qëndronte në qytetin e Vlorës.

Së dyti, sa i takon mosdeklarimit në DPV-në e vitit 2013 të marrëdhënies së qirasë, subjekti ka deklaruar se kjo ka qenë një harresë e tij nga pakujdesia.

Së treti, lidhur me paqartësinë mbi vendin e banimit të shtetasit G. A., gjatë periudhës 2012–2016, subjekti ka deklaruar se ky shtetas ka banuar bashkë me familjen e tij në një apartament në pronësi të tij të ndodhur në lagjen "****", Vlorë dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore.

26.5. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, Komisioni i vlerëson ato bindëse, duke arsyetuar si vijon:

Së pari, argumentet e subjektit, në lidhje me mungesën e formalizimit të kontratës së qirasë me një akt shkresor, çmohen bindëse dhe të bazuara.

Së dyti, mosdeklarimi i marrëdhënies së qirasë në DPV-në e vitit 2013, vlerësohet si një pakujdesi në deklarim, ashtu sikurse subjekti deklaroi, për më tepër, në DPV-në e vitit 2013, si adresë banimi është deklaruar pikërisht adresa e banesës së marrë me qira "Vlorë, 'B., pallati i vjetër 5-katësh, kati i parë, hyrje 3".

Së treti, subjekti ka provuar me dokumente shkresore se shtetasi G. A. ka blerë në vitin 2008 një apartament tjetër në qytetin e Vlorës duke marrë edhe një kredi në vitin 2009, për të cilën ka vendosur në hipotekë apartamentin e marrë me qira nga subjekti.

27. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: "*Banesë private pa numër, me sipërfaqe rreth 100 m² dhe trualli nën të, e ndërtuar para vitit 2006 dhe pa leje ndërtimi në lagjen 'H.', Fshati*

H., Njësia Administrative, S., Bashkia Durrës, banesë e cila ndodhet në proces legalizimi pranë Agjencisë Rajonale të ALUIZNI-t Durrës. Banesa është ndërtuar pa leje ndërtimi, nga babai im para vitit 2006, banesë e cila është deklaruar për legalizim pranë Bashkisë S. në datën 13.11.2006 nga babai im A. S. K.. Kjo pasuri i është lenë nën sime nga të gjithë trashëgimtarët e tjerë ligjore, pa ndonjë akt të shkruar, pasuri për të cilën nuk kanë përfunduar akoma procedurat e legalizimit. Burimi i krijimit: kjo pasuri është ndërtuar nga i ndjeri babai im dhe materialet për ndërtimin e kësaj banese janë blerë nga babai im, me të ardhura të kursyera nga familja. Nuk disponoj shumën e shpenzimeve të kryera për ndërtimin e kësaj banese. Mbi këtë banesë gëzoj vetëm të drejtën e përdorimit, banesë e cila është deklaruar si adresë ku figuron gjendja ime civile që nga viti 2010 dhe në vazhdim në të gjithë deklaratat e mia të pasurisë”.

27.1. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se është larguar nga kjo banesë që nga momenti marrjes së detyrës në datën 15.10.2010, datë kur është shkëputur për të jetuar në Tiranë. Nga verifikimi i deklaramëve të subjektit, konstatohet se në DPFD 2010 – DPV 2016, subjekti ka deklaruar si adresë të regjistrimit në Gjendjen Civile, adresën e kësaj pasurie. Më pas, në DPV-të në vazhdim deri në vitin 2020¹⁴, subjekti ka deklaruar këtë banesë si adresë vendqëndrimi tjetër.

27.2. Duke qenë se subjekti e ka përdorur këtë banesë edhe gjatë periudhës që ka qenë subjekt rivlerësimi, nga Komisioni janë kryer disa verifikime me qëllim evidentimin e origjinës së kësaj pasurie, periudhës së ndërtimit të objektit, si dhe investimeve të mundshme të kryera prej subjektit apo burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për këto investime. Nga aktet në dosje¹⁵, rezultoi se:

- Në vitin 2006, shtetasi A. K. ka aplikuar në Bashkinë S. për leje legalizimi për sipërfaqe të zënë 1.000 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 120 m² (banese 1-katëshe), në fshatin H..
- Me vendimin nr. ***, datë 7.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është çelur dëshmia e trashëgimisë së trashëgimlënësit A. S. K., sipas të cilës subjekti trashëgon 1/5 e pasurisë trashëgimore.
- Në datën 28.12.2016, në emër të A. K. është dhënë leja e legalizimit nr. ***, për objektin godinë banimi 1 kat, pasuria me nr. ***, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 272.03 m², sipërfaqe totale ndërtimi për banim 92.75 m², me 1 kat mbi tokë. Duke qenë se në fotot bashkëngjitur lejes së legalizimit dukej edhe një objekt tjetër me çati me tjegulla, ngjitur me objektin e ndërtuar nga babai i tij, subjektit iu kërkuan sqarime, i cili informoi dhe vërtetoi me dokumente shkresore¹⁶ se ky objekt është në bashkëpronësi të shtetasve L. H. dhe I. H..

¹⁴Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.6.2021, nga ILDKPKI-jë, në dosjen e Komisionit.

¹⁵Shihni aktet në aneksin 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së, shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.1.2021, nga ASHK-ja në dosjen e Komisionit, shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.7.2021 dhe dokumentacionin bashkëngjitur nga ASHK-ja Durrës, në dosjen e Komisionit.

¹⁶Shihni përgjigjet e pyetjeve të datës 16.7.2021, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 26.7.2021, në dosjen e Komisionit.

- FSHU-ja¹⁷ ka informuar për kontratën e energjisë elektrike në emër të shtetasit A. K., të lidhur në datën 25.11.2007.

- UKT-ja Durrës¹⁸ nuk konfirmon kontrata të lidhura për furnizim me ujë për këtë pasuri. Ndërkaq, subjekti ka informuar se kjo banesë nuk është lidhur asnjëherë me rrjetin e ujësjellësit.

27.3. Sa i takon investimeve mbi këtë pasuri, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë sqarime të detajuara dhe dokumente shkresore, sipas të cilave mbi këtë pasuri janë kryer investime që përkojnë me fundin e vitit 2008 nga babi dhe familjarët dhe se trashëgimtarët ligjore të babait kanë shprehur vullnetin që kjo pasuri i është lënë nënës së subjektit, e cila vijon të banojë në këtë banesë. Më tej, deklaroi se në këtë banesë janë kryer disa punime edhe në vitet 2015 dhe 2016, përkatësisht për përshtatjen e ballkonit në kuzhinë dhe veshjen e mureve të jashtme me *polisterol*, të cilat kanë kushtuar në total rreth 450.000 lekë, me kontribut të përbashkët të tij dhe të familjarëve. Në mungesë të të dhënave për kontributin e subjektit në këto investime, Komisioni vlerësoi që të gjithë vlerën prej 450.000 lekësh ta përfshijë si shpenzim në analizën financiare të tij në vlerë të barabartë për vitet 2015 dhe 2016, të cilët rezultojnë me balanca pozitive. Vlen të theksohet se edhe nëse investimet për shtesën do të ishin kryer pas vitit 2010, kur subjekti është bërë subjekt deklarues, do të kishte mundësi për kryerjen e tyre, pasi të gjitha vitet rezultojnë me balanca pozitive.

27.4. Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me këtë pasuri nuk u evidentuan problematika, por u konstatua se subjekti nuk ka deklaruar në DPV-të për vitet 2011 – 2016, 1/5 pjesë takuese të tij të pronësisë së buruar nga trashëgime ligjore e babait, sipas nenit 4 të ligjit 9049/2003, i ndryshuar. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar mosdeklarimi i 1/5 pjesë të pandarë mbi pasurinë, ka të bëjë me mënyrën e të kuptuarit të dispozitave ligjore për sa i përket deklarimit të një pasurie e cila nuk është në qarkullimin civil. Sipas tij, duke qenë se banesa ka qenë në proces legalizimi, pra, e përjashtuar nga qarkullimi civil, ka menduar se nuk duhej ta deklaronte. Në kushtet kur nuk u evidentuan problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri, si dhe në kushtet kur subjekti rregullisht e ka deklaruar adresën e kësaj pasurie si adresë banimi/vendqëndrimi tjetër, pasaktësia në deklarim nuk ka një peshë specifike dhe nuk përbën shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

Deklarata të personave të lidhur

28. Subjekti Albert Kuliçi ka lidhur martesë ligjore me znj. E. T. në datën 8.9.2017, pra, pas deklaratës *Vetting*. Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se bashkëjetesa ka nisur që nga data 15.10.2010, që përkon me momentin e marrjes së detyrës. Me ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014, neni 21, u parashikua detyrimi i deklarimit të pasurisë edhe për bashkëjetuesin/en. Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2014 dhe në vijim konstatohet se bashkëjetuesja ka plotësuar rregullisht “deklaratën e interesave private të personit të lidhur”.

¹⁷Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., nga FSHU-ja, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 25.1.2021, dhe nr. *** prot., datë 10.6.2021, nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.6.2021, nga UKT-ja Durrës, në dosjen e Komisionit.

29. Në deklaratën *Vetting*, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar: “*Depozite në ‘Raiffeisen Invest’ krijuar më 6.5.2014, në vlerën 643.652.08 lekë. Pjesa në %: 100 %. Në datën 21.1.2017 çmimi i kuotës është 1.385.9296. Burimi i krijimit: të ardhura të përfituara nga paga në Prefekturën e Qarkut Vlorë. Shikoni: nxjerrje llogarie nga ‘Raiffeisen Bank’, urdhër për blerjen e kuotave në fondin e investimit, vërtetim mbi pasqyrën e llogarisë*”.

Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëjetueses së subjektit në “Raiffeisen Bank”, rezulton se në datën 6.5.2014, është investuar në fondin “Raiffeisen Prestige”, shuma 543.800 lekë. Ky fond investimi është maturuar në datën 24.5.2017 dhe shuma e përftuar së bashku me interesat është 640.511,16 lekë. Burimi i krijimit të kësaj depozite janë pagat e akumuluar për periudhën 2012 – 6.5.2014, periudhë në të cilën subjekti dhe kjo shtetase kanë qenë në bashkëjetese, të cilat janë kursyer dhe nuk janë tërhequr nga znj. E. T., duke u lënë gjendje në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank”. Nga analiza financiare mbi mundësinë e bashkëjetueses për t’i kursyer këto paga deri në datën 6.5.2014, paraqitur si në tabelën në vijim, rezulton se ka pasur mundësi t’i krijonte këto kursime, duke i mbajtur gjendje në llogarinë bankare.

Përshkrimi	1.1.2014 – 6.5.2014
Pasuritë	-288 209
Investim në “Raiffeisen Invest”, në datën 6.5.2014	543 800
<i>Shtesa/pakësime likuiditetesh</i>	-832 009
Të ardhurat	762 419
Të ardhura nga paga e subjektit	481 879
Të ardhura nga interesa bankare	11 205
Të ardhura nga paga e bashkëjetueses	269 335
Shpenzimet	225 684
Shpenzime jetese për 2 persona	150 684
Shpenzime qiraje	75 000
Mundësia për kursime	824 944

30. Në deklaratën *Vetting*, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar: “*Blerje Bono Thesari, Tirana Bank, më 9.2.2016, me shumë shlyerje 687,305.97, me vlerë nominale 700.000.000, afat 12 muaj. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhura të përfituara nga paga pranë Prefektit të Qarkut Vlorë. Shikoni vërtetim blerje bono thesari; kërkesë për blerje letrash me vlere; kontratë nr. ***; nxjerrje llogarie nga Tirana Bank*”.

Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ¹⁹, evidentohet blerja e bonove të thesarit të cilat janë deklaruar saktësisht nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2016. Nga analiza financiare mbi mundësinë e bashkëjetueses së subjektit për të investuar këtë shumë në Bono Thesari, në datën 11.02.2016²⁰, paraqitur si në tabelën në vijim, rezultoi se ajo ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shumën 700.000 lekë, në datën 11.2.2016, pasi burimi i tyre është nga pagat e kursyera/të pa tërhequra nga “Tirana Bank”.

¹⁹Shihni aneksin 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰Shihni shkresën nr. ***, datë 19.1.2021, nga “Tirana Bank”, administruar në dosjen e Komisionit.

Përshkrimi	1.1.2016 – 11.2.2016
Pasuritë	115 680
Depozitim në “Tiranë Bank”, për investim në Bono Thesari	700 000
<i>Shtesa/pakësime likuiditetesh</i>	-584 320
Të ardhurat	357 579
Të ardhura nga paga e subjektit	236 514
Të ardhura nga interesa bankare	12 694
Të ardhura nga paga e bashkëjetueses	108 371
Shpenzimet	88 847
Shpenzime jetese për 2 persona	51 527
Shpenzime udhëtimi	7 320
Shpenzime qiraje	30 000
Mundësia për kursime	153 052

31. Në deklaratën *Vetting*, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar: “*Të ardhura të patërhequra nga llogaria e pagës në ‘Tirana Bank’ nr. ***. Kjo llogari është kredituar në datën 12.1.2017, në shumën prej 387.000 lekësh, para të cilat janë siguruar nga kursimet cash të bashkëjetuesit Albert Kuliçi nga paga si prokuror. Nga kjo shumë parash, shuma prej 386,262 lekësh është transferuar, në po të njëjtën datë për llogari të ‘H. H. T.’, për shërbime mjekësore. Shikoni: nxjerrje llogarie në ‘Tirana Bank’, vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga Prefekti i Qarkut Vlorë*”.

Këto të ardhura janë deklaruar në të njëjtën mënyrë me subjektin e rivlerësimit dhe sikurse u trajtua në paragrafin 25 të këtij vendimi, nuk janë evidentuar problematika e dyshime.

32. Bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar: “*Depozita në ‘BKT’ krijuar në datën 28.5.2013, në shumën 239,431.47 lekë në vlerën 259,261.72 lekë. Pjesa në %: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhura të përftuara nga paga pranë ‘A.’ sh.p.k. Në datën 18.10.2016 gjendja e llogarisë është sipas vërtetimit nr. *** prot. Shikoni: kontratë depozite bankare, statement of account; vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016, nga ‘A.’ sh.p.k., Tiranë*”.

Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së bashkëjetueses së subjektit në BKT, rezulton se në datën 28.5.2013, shuma prej 239.431.47 lekësh është investuar në depozitë me afat 5-vjeçare dhe është maturuar në datën 28.5.2018. Burimi i krijimit të kësaj depozite janë pagat e akumuluar nga 2011 – 28.5.2013, të cilat janë kursyer dhe nuk janë tërhequr duke u lënë gjendje në llogarinë e pagës së bashkëjetueses në BKT. Nga analiza financiare paraqitur në tabelën në vijim, rezulton se bashkëjetuesja, ka pasur mundësi t’i krijojë këto kursime me të ardhura nga pagat, duke i mbajtur gjendje në llogarinë bankare.

Përshkrimi	1.1. 2013 – 28.5.2013
Pasuritë	596 133
<i>Shtesa/pakësime likuiditetesh</i>	596 133
Gjendja e likuiditeteve	1 143 128
Të ardhurat	1 015 726

Të ardhura nga paga e subjektit	368 074
Të ardhura nga interesa bankare	87
Të ardhura nga paga e bashkëjetueses	253 815
Nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të babait, datë 31.1.2013	393 750
Shpenzimet	189 365
Shpenzime jetese për 2 persona	114 365
Shpenzime qiraje	75 000
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	10 000
Mundësia për kursime	220 228

33. Nëna e subjektit, e cila në deklaratën *Vetting* është deklaruar si pjesë e certifikatës familjare të subjektit, ka deklaruar: *“Sipërfaqe trualli prej 300 m², si dhe ndërtesë mbi këtë truall me sip. 30 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, më adresë në Tropojë, pasuri e cila është regjistruar në emër të bashkëshortit tim, të ndjerit A. S. K. pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tropojë. Kjo pasuri më është lënë mua nga të gjithë trashëgimtarët e tjerë ligjorë, pa ndonjë akt të shkruar, si dhe nuk janë kryer veprimet e kalimit të pronësisë pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tropojë. Burimi i krijimit: kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti im para vitit 1990 dhe nuk e disponoj kontratën e shitblerjes apo shumën e saktë të blerjes së saj, por është blerë me të ardhurat e kursyera nga puna e bashkëshortit tim. Shënim: sipërfaqja e banesës është më e madhe në fakt se sipërfaqja e pasqyruar në regjistrin publik pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tropojë”*.

33.1. Komisioni kreu disa verifikime në lidhje me këtë pasuri, nga ku rezultoi se:

- ASHK-ja Tropojë informoi se në emër të shtetasit A. K. është e regjistruar pasuria e llojit “truall”, me sip. 300 m² dhe 30 m² ndërtesë, me nr. ***, z. k. ***, Tropojë, e regjistruar në datën 25.7.2000²¹. Po kështu, nuk ka informacion për ndërtime të deklaruara/regjistruara në proces legalizimi në Tropojë nga apo subjekti i rivlerësimit²² apo babai i tij.
- Me vendimin nr. ***, datë 7.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është çelur dëshmia e trashëgimisë së trashëgimlënësit A. S. K., duke përcaktuar trashëgimtarët e tij ligjorë, ndër të cilët edhe subjekti Albert Kuliçi, i cili trashëgon 1/5 pjesë të pasurisë.
- FSHU-ja dhe subjekti²³ kanë informuar për kontratë furnizimi të kësaj pasurie me energji elektrike në emër të shtetasit A. K. në instancën Tropojë, Bajram Curri.
- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë sqarime të detajuara dhe dokumente shkresore, sipas të cilave kjo banesë është blerë nga babai i tij në vitin 1986, e më pas janë kryer investime nga ky i fundit dhe familja e origjinës, të cilët kanë banuar në këtë banesë derisa janë shkëputur për të banuar në H. të Durrësit, rreth viteve 2007 - 2008, kur subjekti nuk ka qenë në detyrë. Deklarimet e subjektit se nuk ka pasur investime në këtë pasuri, përputhen me të dhënat e FSHU-

²¹Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.6.2021, nga ASHK-ja Tropojë, në dosjen e Komisionit.

²²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.1.2021, nga ASHK-ja, Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë, në dosjen e Komisionit.

²³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., nga FSHU-ja, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 25.1.2021, në dosjen e Komisionit dhe përgjigjet e subjektit dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike në datën 1.2.2021.

së, sipas të cilave shpenzimet e energjisë elektrike për këtë banesë deri në vitin 2012 kanë qenë të pa konsiderueshme, ndërsa pas vitit 2012 nuk ka pasur shpenzime. Po kështu u vërtetua vullneti i trashëgimtarëve të tjerë të babait të subjektit, që pjesën e tyre takuese në këtë pasuri ia kanë lënë nënës së subjektit.

33.2. Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u evidentuan problematika në lidhje me këtë pasuri, por subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e viteve 2011 - 2016, 1/5 pjesë takuese të tij mbi këtë pasuri, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim, i cili në parashtrimet e tij ka sqaruar se, duke mos qenë në dijeni të faktit që kjo pasuri figuronte e regjistruar në regjistrat publikë, ka vlerësuar se nuk duhej ta deklaronte pjesën takuese prej 1/5 të përfituar nga trashëgimia. Në kushtet kur nuk u evidentuan problematika e dyshime në lidhje me këtë pasuri, si dhe në kushtet kur nuk u vërtetua asnjë investim i kryer prej subjektit në të, pasaktësia në deklarim nuk ka peshë specifike dhe nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

34. Në deklaratën *Vetting*, nëna e subjektit ka deklaruar: *“Banesë private pa numër, me sipërfaqe rreth 100 m² dhe trualli nën të e ndërtuar para vitit 2006 dhe pa leje ndërtimi, ndodhur në lagjen ‘H.’, fshati H., Njësia Administrative S., Bashkia Durrës, banesa është ndërtuar pa leje ndërtimi nga bashkëshorti im A. S. K.. Kjo pasuri më është lënë mua nga të gjithë trashëgimtarët ligjorë pa ndonjë akt të shkruar, pasuri për të cilën nuk është përfunduar akoma procedura e legalizimit. Burimi i krijimit: kjo pasuri është ndërtuar nga bashkëshorti im dhe materialet për ndërtim të kësaj banese janë blerë nga bashkëshorti im me të ardhura të kursyera nga familja. Nuk e disponoj shumën e shpenzimeve të kryera për ndërtimin e kësaj banese”.*

Kjo pasuri është trajtuar më sipër si pasuri e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, për të cilën nuk rezultuan problematika.

35. Në deklaratën *Vetting*, nëna e subjektit ka deklaruar: *“Gjë e gjallë, gjedh (lopë), e matrikulluar me nr. ***. Burimi i krijimit: pasuri e ardhur që nga shpërbërja e ish-kooperativës”.*

36. Motra e subjektit R. K., e cila, edhe pse nuk ka qenë pjesë përbërëse e familjes, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: *“Të ardhura të patërhequra nga llogaria e pagës nr. *** në ‘Raiffeisen Bank’, të derdhura nga subjekti ‘F.’ sh.p.k., me NIPT ***. Shih nxjerrje llogarie nga ‘Raiffeisen Bank’; vërtetim datë 19.1.2017, lëshuar nga subjekti ‘F.’ sh.p.k., në vlerën 20.723,22 lekë. Zotëron: 100 %”.*

Nga verifikimi i të dhënave bankare rezultoi se ky deklarim është i saktë. Nga hetimi administrativ nuk ka pasur të dhëna për pasuri të regjistruara në emër të kësaj shtetaseje.

Konstatime të tjera

37. Me kërkesë të Komisionit, FSHU-ja²⁴ nuk konfirmoi kontrata furnizimi me energji në emër të subjektit të rivlerësimit, bashkëjetueses (sot bashkëshortja), nënës H. K. dhe motrës R. K.. Ndërkaq, FSHU-ja ka konfirmuar 3 kontrata furnizimi me energji në emër të shtetasit A. K. (babai i subjektit), përkatësisht një në instancën Shijak dhe dy kontrata në instancën Kukës, nga

²⁴Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.1.2021, të FSHU-së.

të cilat kontratat nr. *** në Shijak dhe nr. *** në Kukës i përkasin përkatësisht banesave në fshatin H., lagjja “H.”, S., Durrës dhe banesës në Tropojë. I pyetur lidhur me kontratën e furnizimit me energji me nr. ***, subjekti ka deklaruar se²⁵ kjo kontratë nuk i përket babait të tij A. S. K., ndërkohë që ka informuar se kjo kontratë i përket shtetasit A. B. K. banues në lagjen “P.”, Tropojë. Për të vërtetuar këto pretendime subjekti ka paraqitur: (i) certifikatë personale dhe familjare të shtetasit A. B. K.; (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 25.6.2021, nga FSHU-ja, nga ku rezulton që deklaratimet e subjektit janë të vërteta.

38. ASHK-ja nuk ka konfirmuar pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit apo prindërve të tij²⁶.

39. Në DPDFD-në e vitit 2010 dhe në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi: rruga “A. L.”, nr. ***, Tiranë. Në përgjigje të pyetësorit standard në lidhje me këtë adresë, subjekti ka sqaruar se nga data 15.10.2010, që përkon me marrjen e detyrës si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, ka banuar në një banesë private me nr. ***, në Tiranë, e cila ka pasur këtë adresë. Banesa ka qenë e marrë me qira nga bashkëjetuesja dhe është paguar prej saj, por pa u nënshkruar një kontratë formale. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka informuar se kjo banesë ka qenë në pronësi të shtetasit Gj. H. dhe ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.6.2021, të këtij shtetasi, im cili konfirmon deklaratimet e subjektit dhe qiranë mujore prej 15.000 lekësh (kjo shumë u përfshi si shpenzim në analizën financiare). Ky shtetas pohon gjithashtu se kjo banesë, e cila është prishur në kuadër të një projekti për zhvillimin urban, është ndërtuar prej tij në vitin 1992 dhe në vitin 2005 është futur për legalizim, sipas vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 24.3.2005 (bashkëlidhur deklaratës noteriale). Në lidhje me shtetasin Gj. H., pas verifikimeve të kryera, nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi²⁷ apo përfshirje të tij në veprimtari të krimit të organizuar²⁸.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk ka pasur dyshime për lidhje të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri.

40. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nga prilli i vitit 2017 ka banuar në Vlorë në një banesë, pa qira, së bashku me bashkëshorten, e më pas edhe vajzën, duke bashkëlidhur kontratën e huapërdorjes së banesës nr. ***, datë 21.7.2017 (sipas të cilës kontrata fillon efektet në prill të vitit 2017) dhe certifikatën e pronësisë në emër të shtetasit P. B., për pasurinë apartament, me sip. 50 m², me nr. ***. Sipas kësaj kontrate dhe deklaratimeve të subjektit në DPV pas deklaratës *Vetting*, subjekti e ka përdorur apartamentin nga data 1.4.2017 e në vijim.

Siç vërehet, në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, subjekti nuk e ka pasur në përdorim këtë banesë. Por, duke qenë se është deklaruar përdorimi i kësaj pasurie, në përgjigje të pyetësorit standard, dhe sipas kontratës, e drejta e përdorimit është pa afat dhe pa kundërshtpërblim, me qëllim evidentimin e çdo lloj lidhjeje të subjektit me këtë pasuri, si dhe burimit të ligjshëm të të

²⁵Shihni përgjigjet e subjektit dërguar në rrugë elektronike në datën 25.6.2021, në dosjen e Komisionit.

²⁶Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.1.2021, nga ASHK-ja, në dosjen e Komisionit.

²⁷Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 26.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

²⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.7.2021, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e saj nga huadhënësi P. B., Komisioni ka kryer disa verifikime, nga të cilat rezultoi se:

40.1. Noteri E. A.²⁹ vuri në dispozicion: (i) kopje të kontratës së huapërdorjes nr. ***, datë 21.7.2017; (ii) kopje të certifikatës për vërtetim pronësie të apartamentit me sip. 50 m², në pronësi të shtetasit P. B.; (iii) kartelë të pasurisë së apartamentit, sipas të cilës është regjistruar në datën 5.4.2017, në emër të shtetasit P. B.; (iv) faqen nr. *** të regjistrimit noterial, në të cilën është regjistruar kontrata e huapërdorjes nr. ***, datë 21.7.2017³⁰. Në kartelën e pasurisë konstatohet se shtetasi P. B. e ka përfituar këtë pasuri nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. ***, datë 21.3.2017, nga shoqëria “A.” sh.p.k., me administrator A. A., e regjistruar në pronësi të saj që prej vitit 2009. Ndërsa, në datën 5.4.2017, ky apartament është regjistruar në emër të shtetasit P. B..

40.2. Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Vlorë³¹ informoi se regjistrimi i subjektit në adresën: lagjja “D.”, rruga “J. D. R.”, pallati A., kati ***, është bërë bazuar në kontratën e huapërdorjes së banesë me nr. ***, datë 21.7.2017.

40.3. Ministria e Drejtësisë informoi se nuk rezultoi i regjistruar në ndonjë zyrë noteriale testamenti i lëshuar nga shtetasi P. B.³².

40.4. FSHU-ja informoi se kontrata e energjisë për këtë pasuri, me nr. ***, i përket shtetasit S. B. (djali i huadhënësit P. B.) dhe është lidhur në emër të tij në datën 28.2.2010³³. Ndërsa, UKT-ja Vlorë informoi se për këtë pasuri është lidhur kontrata nr. *** në emër të shtetasit A. A. (administratori i shoqërisë “A.” sh.p.k.). Gjithashtu, subjekti vuri në dispozicion librezat e furnizimit me energji elektrike në emër të këtyre shtetasve³⁴.

40.5. I pyetur në lidhje me relatat me shtetasin P. B. dhe arsyen e marrjes në përdorim pa afat dhe pa shpërblim të banesës së tij, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se: *“[...] me z. P. B. dhe familjen e tij është njohur pasi ka filluar punë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, fillimisht nga njohja me djalin e tij O. B., OPGJ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në periudhën shtator 2010 e deri në fund të muajit shtator 2016. Nëpërmjet këtij shtetasi është njohur edhe me vëllain e tij S. B., i cili ka jetuar në banesën në fjalë nga viti 2010 deri prill të vitit 2015. Pas largimit nga kjo banesë të z. S. B. aty ka banuar deri në fund të muajit shtator të 2016-ës z. O. B., së bashku me bashkëjetuesen e tij, znj. L. G.. Pas transferimit të tij me punë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2016, për shkak të marrëdhënieve miqësore subjektit iu krijua mundësia që të jetonte në këtë banesë bashkë me bashkëshorten, pa kundërshtim. Banesa është me një sipërfaqe të vogël prej 50 m², e përbëhet nga një dhomë e kuzhinë dhe pa ballkon, e për këtë arsye familja e tyre nuk kishin interes ta jepnin me qira, për faktin se edhe qiraja mujore nuk shkonte më shumë se 10.000 (dhjetë mijë) lekë [...]”*

²⁹Shihni shkresën kthim përgjigje të noterit E. A., protokolluar me nr. *** prot., datë 21.6.2021, në dosjen e Komisionit.

³⁰Shihni shkresën datë 2.7.2021, nga noteri E. A., protokolluar me nr. *** prot., datë 6.7.2021, në dosjen e Komisionit.

³¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.6.2021, nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Vlorë, në dosjen e Komisionit.

³²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.6.2021, nga Ministria e Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.

³³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.6.2021, nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

³⁴Shihni përgjigjet e subjektit dhe dokumentacionin bashkëngjitur, dërguar në rrugë elektronike në datën 1.2.2021, në dosjen e Komisionit.

Më tej, subjekti ka deklaruar se: *“Fakti që nuk është nënshkruar kontratë qiraje, por kontratë huapërdorjeje është për shkak se nëse do të nënshkruhej kontratë qiraje ajo do të ishte fiktive, për arsyen se z. P. B. dhe familja e tij nuk pranojnë që të marrin qira nga subjekti për këtë banesë”*. Sipas subjektit marrëdhënia miqësore ndërmjet dy familjeve është një marrëdhënie që njihet edhe nga publiku, për faktin që kanë hyrje-dalje mes tyre.

Përveç sa më sipër, subjekti ka sqaruar dhe dokumentuar se shtetasi P. B. dhe bashkëshortja e tij E. B. banojnë në një apartament tjetër në Vlorë, i cili është blerë që në vitin 1996 dhe është i regjistruar në emër të kësaj të fundit.

40.6. Në lidhje me shtetasit P., S. dhe O. B., pas verifikimeve të kryera nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi të subjektit të rivlerësimit³⁵ apo përfshirje të tyre në veprimtari të krimit të organizuar³⁶. Po kështu, SPAK³⁷ nuk ka konfirmuar procedime penale ose pasurore në emër të shtetasit A. A. dhe deri në këtë fazë të hetimit administrativ nuk kanë rezultuar të dhëna për konflikt interesi të subjektit me këtë shtetas³⁸.

40.7. I pyetur në lidhje me rrethanat e përfitimit të pasurisë prej huadhënësit P. B., me kontratën e dhurimit të vitit 2017, në përgjigjet e tij të datës 26.7.2021, subjekti ka informuar se djali i huadhënësit, shtetasi S. B., në marrëveshje me shoqërinë “A.” sh.p.k. ka investuar shumën 4.709.000 lekë në vitin 2008, në ndërtimin e objektit 7-katësh të ndërtuar sipas rregullave ligjore dhe të hipotekuar në emër të kësaj shoqërie në vitin 2009. Për shkak të kësaj marrëdhënieje, shtetasi S. B. ka përfutur këtë apartament në vitin 2010, vit në të cilin ka lidhur kontratën e furnizimit me energji elektrike në emër të tij. Kalimi i pronësisë është bërë me marrëveshje mes palëve, përmes kontratës së dhurimit të datës 21.3.2017, në emër të babait të z. S. B., shtetasi P. B..

40.8. Në lidhje me burimin e të ardhurave për pagimin e investimit prej 4.709.000 lekësh nga shtetasi S. B., subjekti ka informuar se ato burojnë nga shitja e një apartamenti përmes kontratës së premtim shitjes nr. ***, datë 9.4.2008, në shumën 52.000 euro, për të cilën nuk është paguar tatim, pasi këtë apartament shtetasi S. B. e ka blerë përmes kontratës së shitjes paraprake nr. ***, datë 19.3.2007, me të njëjtin çmim prej 52.000 euro³⁹. Në parashtrimet e tij, ai ka bërë me dije se apartamenti i është shitur shtetasit E. L., i cili është subjekt deklarues në ILDKPKI dhe nga verifikimet e kryera ky shtetas e ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti në DPV-në e vitit 2008, të cilën e ka vënë në dispozicion të Komisionit.

40.9. Në mbështetje të pretendimeve të tij, gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigjet e tij të datës 26.7.2021, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore⁴⁰.

³⁵Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 21.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

³⁶Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.7.2021, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

³⁷Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.7.2021, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

³⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.7.2021, nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

³⁹Paraqitur bashkëlidhur me parashtrimet.

⁴⁰Shihni: (i) vërtetimin datë 21.7.2021, të lëshuar nga subjekti “A.” sh.p.k.; (ii) aktrakordimin e datës 31.7.2008, të shoqërisë “A.” sh.p.k.; (iii) vendimin nr. ***, datë 13.11.2007, të KRRT-së Vlorë, për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe kushteve të tij urbane për objektin godinë 7-katëshe, 1 kat dyqan, 6 kate banimi, në lagjen “****”, Vlorë; (iv) lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr. ***, datë 14.12.2007, të shoqërisë “A.” sh.p.k., për ndërtimin e banesës 7-katëshe, 1 kat dyqan, 6 kate banimi, në

40.10. Shoqëria “A.” sh.p.k.⁴¹, duke konfirmuar faktin se shtetasi S. B. ka banuar në këtë apartament në cilësinë e investitorit që nga përfundimi i objektit, informoi se me këtë shtetas, por edhe me investitorët e tjerë, nuk është nënshkruar kontratë formale për shumat e investuara, pasi marrëveshja ka qenë verbale. Në lidhje me depozitim të shumave të investuara, kthimin e tyre në formë të shpërndarjes së fitimit apo përfitimit të pasurive të paluajtshme, shoqëria informon se për asnjërin prej investitorëve nuk disponon dokumente, për faktin se ky subjekt ka pezulluar ushtrimin e aktivitetit që në vitin 2009 dhe në qershor të vitit 2010 ka kaluar në statusin pasiv. Ndërkaq, ka vënë në dispozicion disa dokumente shkresore dhe duke listuar pasuritë e përfituara nga investitorët informon se me kërkesë të shtetasit S. B. apartamenti i ka kaluar në pronësi shtetasit P. B. me kontratë dhurimit në vitin 2017. Nga verifikimi i bilanceve të shoqërisë “A.” sh.p.k. të viteve 2008 dhe 2009 (të vetmet bilance të gjendura në faqen zyrtare të QKR-së), rezulton se shumat e depozituara nga investitorët, sipas aktakordimit të datës 31.7.2008, paraqitur nga shoqëria “A.” sh.p.k., nuk janë të pasqyruara në bilancet përkatëse të të dyja viteve.

40.11. Pas verifikimeve gjatë procesit të rivlerësimit, nuk janë evidentuar transaksione bankare ose ndërveprime të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me shoqërinë “A.” sh.p.k. dhe as kontrata me FSHU-në, UKT-në, etj., apo marrëveshje të çdo lloji për këtë pasuri.

40.12. Në përfundim të hetimit administrativ, edhe pse nuk u evidentuan lidhje të subjektit me pronësinë e pasurisë, objekt shqyrtimi, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua për të dhënë shpjegime/dokumente të mëtejshme, duke iu bërë me dije se:

- Është e paqartë origjina e krijimit të pasurisë, pasi investimi në shumën 4.709.000 lekë, i kryer nga shtetasi S. B., i cili përbën shkakun e përfitimit të pasurisë prej tij, mbetet në nivel deklarativ dhe i paformalizuar me akt shkresor, për shkak se: (i) nuk vërtetohet periudha dhe fakti që shuma prej 4.709.000 lekësh është paguar në arkën e shoqërisë; (ii) depozitimi i kësaj shume nuk është regjistruar në librat e kontabilitetit të shoqërisë/bilancet e shoqërisë; si dhe (iii) nuk ka asnjë dokument shkresor në kohë reale që të provojë marrëveshjen midis palëve për përfitimin e apartamentit me sip. 50 m² prej shtetasit S. B..

- Është e paqartë përse kalimi i pronësisë mbi pasurinë është kryer nga shoqëria në vitin 2017 në emër të shtetasit P. B., dhe për më tepër me kontratë dhurimi, ndërkohë që pasuria ishte regjistruar në emër të shoqërisë “A.” sh.p.k. në datën 19.6.2009.

- Janë të paqarta rrethanat në të cilat shtetasi P. B. ia ka dhënë pasurinë subjektit të rivlerësimit në huapërdorje pa shpërbllim, pa afat dhe të mobiluar⁴², menjëherë me fitimin e pronësisë me kontratë dhurimi.

lagjen “****”, Vlorë”; (v) kontratën e shitjes paraprake nr. ***, datë 19.3.2007; (vi) kontratën e premtim shitjes nr. ***, datë 9.4.2008; (vii) kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 23.4.2007; (viii) certifikatën për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 5.10.2005; (ix) kontratën e dhurimit datë 21.3.2017; (x) certifikatë për vërtetim pronësie dhe kartelën e pasurisë apartament, me nr. pasurie ***, (xi) të dhënat e klientit të kontratës ***, (xii) deklaratën noteriale nr. ***, datë 22.7.2021, të shtetasit S. B.; (xiii) certifikatën për vërtetim pronësie lëshuar në datën 13.9.2013, nga ZVRPP-ja Vlorë; (xiv) kontratën e shitjes nr. ***, datë 12.9.2013, të papafingos; (xv) certifikatën për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 6.9.2013, nga ZVRPP-ja Vlorë; si dhe (xvi) deklaratën noteriale nr. ***, datë 22.7.2021, të shtetasit P. B..

⁴¹Shihni shkresën kthim përgjigje datë 27.7.2021, nga subjekti “A.” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

⁴²Shihni përgjigjet e pyetësorit standard.

40.13. Në parashtrimet e tij, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me këto paqartësi, duke mbështetur në çdo rast deklaratimet e tij me dokumente shkresore⁴³. Në mënyrë të përmbledhur, Komisioni vlerësoi parashtrimet e subjektit, si vijon:

Së pari, në lidhje me rrethanat në të cilat shtetasi P. B. ia ka dhënë pasurinë subjektit të rivlerësimit në huapërdorje dhe pa shpërblim, subjekti vijon të japë argumente, sipas të cilave arsyeja e vetme ka të bëjë me marrëdhënien miqësore ndërmjet dy familjeve, fakt ky i njohur publikisht në qytetin e Vlorës, si dhe në kushtet kur ky apartament nuk përdorej nga askush prej anëtarëve të familjes B.. Për të dokumentuar këtë marrëdhënie, subjekti ka paraqitur, midis të tjerash, foto ku tregohet se shtetasi S. B. dhe bashkëshortja e tij kanë qenë dëshmitarë në lidhjen e martesës së subjektit në vitin 2017.

Së dyti, sa i takon kalimit të pronësisë me dhurim dhe jo me shitje në emër të shtetasit P. B., sipas subjektit kjo ka lidhje me rrethanat në të cilat apartamenti është përfituar pas një marrëveshjeje të paformalizuar me shoqërinë "A." sh.p.k. Sa i takon kalimit të pronësisë *de jure* të pasurisë në emër të shtetasit P. B. në vitin 2017, vlerësohet nga Komisioni se kjo ka qenë një marrëveshje e lidhur me vullnetin e lirë të palëve kontraktuese që nuk ka lidhje me veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, e për më tepër, u vërtetua se *de facto* pasuria ka qenë nën zotërimin e shtetasit S. B. që në vitin 2010.

Së treti, Komisioni i çmon të bazuara argumentet e subjektit, sipas të cilit, edhe pse nuk është vërtetuar investimi në shumën 4.709.000 lekë nga shtetasi S. B. në kohë reale, nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ është vërtetuar marrëdhënia midis shoqërisë së ndërtimit dhe investitorëve, si dhe dakordësia që secili prej investitorëve do të merrte vlerën e investimit të konvertuar në pasuri të paluajtshme. Ndërkohë, me të drejtë subjekti pretendon se mungesa e deklaratimit të shumës së investimit të investitorit S. B. (dhe jo vetëm) në bilancet e shoqërisë, nuk provon faktin se ky shtetas nuk ka qenë investitor, por provon faktin se shoqëria nuk ka deklaruar në organet tatimore asnjërin prej investitorëve. Në këto kushte, dhe në vlerësim të të gjitha rrethanave të çështjes, mungesa e dokumentimit të investimit të shumës prej 4.709.000 lekësh nga shtetasi S. B. pranë shoqërisë "A." sh.p.k., nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit, për më tepër, kur nuk u evidentua asnjë lidhje e tij (veprim, transaksion, kontratë a marrëveshje) me pasurinë objekt shqyrtimi, origjina e të cilës daton në periudhën 2009, kur është regjistruar në emër të shoqërisë ndërtimore, duke vijuar me vitin 2010, kur ka filluar të përdoret nga shtetasi S. B..

40.14. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit: (i) nuk u evidentua asnjë lidhje midis subjektit të rivlerësimit me pronësinë e pasurisë objekt shqyrtimi, pasuri e cila u

⁴³Shihni: (i) certifikatën familjare të shtetasit P. B., lëshuar në datën 23.7.2021; (ii) certifikatën familjare të shtetasit S. B., lëshuar në datën 26.9.2021; (iii) certifikatën familjare të shtetasit A. M. (B.), lëshuar në datën 27.9.2021; (iv) certifikatën familjare të shtetasit L. G.; (v) deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.10.2010, e nënshkruar nga shtetasit A. G., V. G., O. B. dhe L. G.; (vi) shkresën nr. *** prot, datë 15.9.2010, të Prokurorisë së Përgjithshme; (vii) shkresën nr. *** prot., datë 3.10.2016, të Prokurorisë së Përgjithshme; (viii) urdhrin nr. ***, datë 3.10.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm; (ix) kopjen e librezës së energjisë elektrike me nr. ***, që i përket shtetasit L. L.; (x) të dhënat në lidhje me kontratën për furnizim me energji elektrike në emër shtetasit L. L., me nr. kontrate ***, (xi) kopjen e librezës së ujit, me nr. ***, që i përket shtetasit L. L.; (xii) shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021, të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, me 26 (njëzet e gjashtë) kartelat e regjistrimit të pasurisë për pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. *** dhe të njëjtit e apartamenteve që ngrihen mbi këtë pasuri; si dhe (xiii) 19 (nëntëmbëdhjetë) fotografi të cilat ndodhen të administruara në një CD.

vërtetua të jetë përfituar nga shtetasi S. B. në vitin 2010, kur subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrë; (ii) u vërtetua që dhënia e pasurisë në përdorim pa shpërblim, ka qenë për shkak të marrëdhënieve familjare e miqësore me familjen B., me anëtarët e të cilës nuk rezultoi që subjekti të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit; (iii) dhënia e pasurisë në huapërdorje, pa afat, është bërë me vullnet të lirë të palëve në kontratë, ndikuar edhe nga natyra e punës së prokurorit dhe pasigurisë së vijimit të detyrës pranë të njëjtës prokurori, ashtu sikurse me të drejtë subjekti pretendoi.

41. Nga të dhënat e hyrje-daljeve të sistemit *TIMS* ka rezultuar se subjekti ka udhëtuar me automjetet me targat ***, ***, ***, ***, ***, ***, ***, ***, ***, ***. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se udhëtimet e tij kanë qenë më së shumti për qëllime turistike dhe për të takuar të afërm jashtë shtetit. Nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë rasti konflikti interesi⁴⁴ apo përfshirje të tyre në veprimtari të krimin të organizuar⁴⁵ të shtetasve të deklaruar nga subjekti dhe ata të rezultuar nga të dhënat e policëmbajtësit në sistemin e AMF-së, nuk kanë rezultuar të dhëna.

Analizë financiare

42. Për të verifikuar justifikimin e pasurive dhe shpenzimeve gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit me të ardhura të ligjshme, në përfundim të hetimit administrativ, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni ka kryer analizën financiare e cila është përmbledhur si në tabelën vijuese, sipas të cilës subjekti ka rezultuar me balanca pozitive.

0	1	2	3	4
Përshkrimi	Pasuri	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kurse (2-1-3)
2010	8 134	255 169	116 925	130 110
2011	375 553	1 239 939	620 103	244 283
2012	302 238	1 424 945	487 054	635 652
2013	846 673	1 903 258	486 631	569 954
2014	603 287	1 837 447	844 172	389 988
2015	500 894	2 062 879	890 331	671 655
2016	456 493	2 232 005	937 964	837 548
Total	3 093 271	10 955 642	4 383 180	3 479 191

43. Metodologjia e përdorur gjatë analizës financiare

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në

⁴⁴Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 26.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

⁴⁵Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.7.2021, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

Të ardhurat

Subjekti është analizuar së bashku me bashkëjetuesen e tij për të gjithë periudhën e rivlerësimit 15.10.2010 – 31.12.2016 dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare janë konsideruar të ardhurat e dokumentuara nga:

- pagat e subjektit, duke filluar nga data e emërimit në detyrë⁴⁶;
- pagat e bashkëjetueses për të njëjtën periudhë⁴⁷;
- të ardhura nga interesa bankare të subjektit⁴⁸ dhe bashkëjetueses së tij⁴⁹;
- të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të babait të subjektit⁵⁰.

Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlogaritur për dy persona për të gjithë periudhën e rivlerësimit, sipas standardit të ILDKPKI-së.
- Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin nr. 11 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Shpenzimet e qirasë gjatë kryerjes së stazhit në Tiranë janë konsideruar vlera e qirasë 15.000 lekë/muaj, sipas kontratës së qirasë së bashkëjetueses, për periudhën 15.10.2010 – 31.12.2011; gjatë qëndrimit në Vlorë është konsideruar vlera e qirasë 15.000 lekë/muaj, për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2016, sipas deklarimeve të subjektit, të mbështetura me deklaratën noteriale të qiradhënësit.
- Janë përfshirë pagesat e detyrimeve doganore dhe shpenzimet për regjistrimin e automjetit të blerë në vitin 2011, sikurse janë evidentuar gjatë hetimit administrativ.
- Janë përfshirë shpenzimet për disa punime të kryera në banesën e babait të tij në Hidrovor, në mënyrë të barabartë për vitet 2015 dhe 2016, sikurse deklaruar nga subjekti në pyetësin nr. 2.

Pasuritë

- Është përfshirë automjeti i blerë nga subjekti në vitin 2011, me vlerën bazuar në kontratën e shitjes.

⁴⁶Vërtetimet: datë 14.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 15.10.2010 – 15.10.2011 dhe nr. ***, datë 19.1.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 16.10.2010 – 31.12.2016.

⁴⁷Vërtetimet: nr. ***, datë 20.10.2016, nga shoqëria "A." sh.p.k., për periudhën 2.6.2008 – 31.12.2011 dhe nr. ***, datë 2.1.2017, nga zyra e prefektit të qarkut Vlorë, për periudhën e punësimit 1.4.2012 – 31.12.2016.

⁴⁸Vërtetim nr. *** prot., datë 2.2.2021, nga "Intesa Sanpaolo Bank".

⁴⁹Vërtetimet: nr. *** prot., datë 22.1.2021, nga BKT-ja dhe nr. *** prot., datë 19.1.2021, nga "Tirana Bank".

⁵⁰Vendim nr. ***, datë 14.6.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 12.6.2012 dhe lëvizjet e llogarisë në "Intesa Sanpaolo Bank".

- Likuiditetet janë trajtuar si pjesë e pasurive, në një zë të veçantë. Këtu janë përfshirë gjendjet e llogarive bankare⁵¹ në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash*, sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.
- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.
- shuma e pasurive dhe likuiditeteve përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti, nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

Rezultati financiar është i përlogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total.

Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhurave - shpenzime - pasuri, për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë

44. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, z. Albert Kuliçi, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të këtij ligji, për shkak se: (i) ka kryer deklarime të sakta në përputhje me ligjin (germa “a” e pikës 5); (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (germa “b” e pikës 5); (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë (germa “c” e pikës 5); si dhe (iv) nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa “d” e pikës 5).

Kontrolli i figurës

45. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 dhe ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 29.6.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruar prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në

⁵¹Shkresat: nr. *** prot., nga “Intesa Sanpaolo Bank”; nr. *** prot., datë 11.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”; nr. *** prot., datë 19.5.2020, nga BKT; nr. *** prot., datë 4.5.2020, nga ABI Bank; nr. *** prot., datë 11.9.2020, nga “Credins Bank”.

krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Albert A. Kuliçi.

45.1. Gjatë hetimit administrativ, pas kërkesës së Komisionit për përditësim të dhënash, me shkresë konfidenciale, DSIK-ja ka njoftuar se nuk ka ndryshuar konstatimin fillestar për subjektin Albert Kuliçi. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ nuk ka pasur të dhëna konkrete për veprimtari të subjektit që cenojnë figurën e tij, të tilla që do të bënin të domosdoshëm kryerjen e hetimeve të mëtejshme.

45.2. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës të DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Albert Kuliçi është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i aftësive profesionale

46. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Albert Kuliçi, bazuar në: (i) raportin me nr. *** prot., për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLP-ja, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 17.6.2021; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti për analizën e aftësive profesionale nga KLP-ja

47. Analiza e kryer nga KLP-ja, në vlerësimin e aftësive, është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore. Në përfundim, KLP-ja, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit, si vijon:

47.1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret, si dhe ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Albert Kuliçi shfaq aftësi shumë të mira në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe

niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

47.2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Afatet kohore të zgjidhjes së praktikave, që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse. Pasi është verifikuar kohëzgjatja e trajtimit të praktikave në dosjet e përzgjedhura nga subjekti dhe ato të caktuara me short, konstatohet se subjekti Albert Kuliçi ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementëve të veprës penale. Në procedimet penale për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve është argumentuar vendimmarrja për pushimin e procedimeve penale. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme mbi kontrollin e hetimeve në lidhje me çështjet me të pandehur, të dërguara për gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Albert Kuliçi, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

47.3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016 rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Integriteti

Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e subjektit të rivlerësimit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Albert Kuliçi. Nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

47.4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nuk rezultojnë të dhëna që cenojnë mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk rezultojnë të dhëna konkrete që tregojnë aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti Albert Kuliçi rezulton të jetë angazhuar në një sërë aktivitete profesionale të organizuara.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme

48. Si informacion i marrë nga burime të ligjshme janë konsideruar informacionet e marra nga: (i) tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj; (ii) 11 denoncime nga publiku të administruara për subjektin e rivlerësimit. Në 6 nga këto denoncime⁵² nuk referoheshin shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit ose ngiheshin pretendime mbi vendimmarrje të padrejtë të subjektit, vlerësimi i të cilave, në zbatim të pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, është jashtë tagrit të vlerësimit nga Komisioni, ndërsa për pesë denoncime janë kryer verifikimet si vijojnë:

49. Denoncim nga shtetasi M. Xh.⁵³ dhe në këtë denoncim ngre pretendime për zvarritje hetimesh nga prokurori, pa paraqitur dokumente bashkëngjitur denoncimit të tij. Me qëllim verifikimin e këtyre pretendimeve, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dosjen e procedimit penal nr. ***⁵⁴, nga analizimi i akteve të së cilës, u konstatua se:

- i) nga data e paraqitjes së kallëzimit penal (28.1.2019) deri në datën e paraqitjes së kërkesës për pushimin e procedimit penal (3.12.2020), kohëzgjatja e hetimeve ka qenë rreth 23 muaj;
- ii) nga data e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale (15.1.2020) deri në datën e paraqitjes së kërkesës për pushimin e procedimit penal (3.12.2020), kohëzgjatja e hetimeve ka qenë rreth 11.5 muaj;
- iii) ka pasur tri vendime për zgjatje të afatit të hetimeve, përkatësisht të datave 14.4.2020, 14.7.2020 dhe 14.10.2020, me nga tre muaj secili;
- iv) nuk rezulton të jetë e dokumentuar në dosje marrja dijani e kallëzuesit/viktimës për dy vendimet e para të zgjatjes së afatit të hetimeve sipas nenit 324/3 të Kodit të Procedurës Penale;
- v) vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 14.4.2020, është marrë pas 3 muajsh nga data e regjistrimit të emrit të personit (15.1.2020), të cilit i atribuohet vepra penale, ndërkohë që sipas nenit 323/2 të Kodit të Procedurës Penale, afati i përfundimit të hetimeve është 3 muaj. Në këtë vendim nuk janë përcaktuar veprimet hetimore konkrete që duhen kryer;
- vi) vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve të datave 14.7.2020 dhe 14.10.2020 nuk janë të arsyetuara sa i takon përmbushjes së elementëve të nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat kushtëzojnë shtyrjen e afatit të hetimeve, vetëm në rastin e hetimeve komplekse ose të

⁵²Shihni kërkesë-ankesën nga shtetasi A. B., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 7.6.2019 dhe denoncimet nga: shtetasi K. L., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 26.11.2018; shtetasia L. H. L., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 17.10.2018; shtetasi L. M., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 15.5.2018; shtetasi A. V., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 23.7.2021; shtetasi B. V. S., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 26.11.2018 në dosjen e Komisionit.

⁵³Shihni denoncimin nga shtetasi M. Xh., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 2.4.2021, në dosjen e Komisionit.

⁵⁴Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Vërehet se afati i hetimeve është shtyrë dy herë me argumentin se nuk është administruar vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, mbi bazën e ankimit të shtetasit M. Xh., pa u argumentuar se përse është thelbësor për hetimin ky vendim dhe, në përfundim, prokurori ka vendosur pushimin e procedimit penal pa administruar këtë vendim;

vii) nuk ka informacion mbi vendimmarrjen e gjykatës lidhur me kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes.

49.1. Në përfundim, të hetimit administrativ duket se ka zvarritje të hetimit për shkak të shtyrjes tri herë të afatit të hetimeve për shkaqe jo tërësisht të justifikuara sipas parashikimeve të nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkuan sqarime lidhur me këto konstatime. Në parashtrimet e tij lidhur me këtë konstatim subjekti ka sqaruar se:

Së pari, në lidhje me kohëzgjatjen e hetimit të kësaj çështjeje subjekti ka deklaruar se ka ardhur për shkak të ngarkesës së lartë në punë, natyrës së çështjes së hetuar, veprimeve të shumta hetimore që duheshin kryer, si dhe për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19. Për të mbështetur këto pretendime subjekti ka paraqitur si provë: (i) urdhrin nr. ***, datë 7.2.2019, të Drejtuesit të Prokurorisë “Për emërimin e zëvendësdrejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”; (ii) evidencën e treguesve të ndjekjes penale për harkun kohor 1.1.2019 – 31.12.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilën janë pasqyruar dosjet e përfunduara nga subjekti gjatë kësaj periudhe; (iii) fletën nr. *** dhe ***, të analizës vjetore 2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilën është e pasqyruar ngarkesa e punës përgjatë vitit 2019 edhe për subjektin Albert Kuliçi; (iv) tabelën e çështjeve në ndjekje nga NJPH-ja Vlorë për harkun kohor 1.1.2019 - 31.12.2019, tabelë e cila mbahet nga subjekti, sipas së cilës provohet fakti se gjatë kësaj periudhe ka pasur në hetim 222 kallëzime/procedime penale.

Së dyti, në lidhje me njoftimin e vendimeve të zgjatjes së afatit të hetimit, subjekti ka informuar se: (i) vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve të marrë më 14.4.2020 i është njoftuar personit nën hetim dhe kallëzuesit/viktimës së veprës penale përmes shërbimit postar dhe, konkretisht, përmes shkresës nr. *** prot., (A. K.), datë 14.4.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në fletën nr. *** të fashikullit të administruar; (ii) vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve të marrë më 14.7.2020 i është njoftuar personit nën hetim dhe kallëzuesit/viktimës së veprës penale përmes shërbimit postar dhe, konkretisht, përmes shkresës nr. *** prot., (A. K.), datë 20.7.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në fletën nr. *** të fashikullit të administruar.

Së treti, në lidhje me konstatimin se vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve të datave 14.7.2020 dhe 14.10.2020 nuk janë të arsyetuara sa i takon përmbushjes së elementëve të nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka sqaruar se në interpretimin dhe qëndrimin e mbajtur prej tij, zgjatja për herë të parë e hetimeve nuk kërkon që të identifikohet rasti i hetimit kompleks apo pamundësisë objektive. Sipas tij, neni 324/1 i Kodit të Procedurës Penale i jep mundësinë prokurorit për të zgjatur afatin e hetimit deri në 3 muaj, pa e kushtëzuar me kompleksitetin e çështjes apo pamundësinë objektive, pra nuk ka parashikuar ndonjë kriter ligjor në lidhje me

rastin e parë të zgjatjes së afatit të hetimeve. Vetëm në rastet e tjera të zgjatjes së afatit të hetimeve, ligjvënësi ka kërkuar si kusht ekzistencën e hetimeve komplekse apo pamundësinë objektive për t'i kryer hetimet brenda afatit të zgjatur. Ndërkohë, dy vendimet e zgjatjes së afatit të hetimeve janë zgjatur për faktin se në përputhje me nenin 71 të Kodit të Procedurës Penale është pritur të administrohet vendimi gjyqësor i formës së prerë, që edhe pse janë zgjatur afatet e hetimit nuk është administruar për shkak se në Gjykatën e Apelit Vlorë, sipas shkresës nr. *** prot., datë 8.10.2020, nuk ishte planifikuar për gjykim deri në këtë datë. Ndërsa në lidhje me përfundimin e hetimeve pa administruar vendimin gjyqësor të formës së prerë, sipas subjektit qëndron, por ka sqaruar se për këtë fakt ka arsyetuar në kërkesën për pushimin e çështjes përpara gjykatës, arsyetim sipas të cilit mungon elementi i anës subjektive të veprës penale “shpërdorim i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Së katërti, në lidhje me konstatimin se në vendimin e datës 14.4.2020 nuk janë identifikuar veprimet konkrete që duhen kryer, subjekti deklaron se qëndron, por sqaron se në kohën kur është marrë ky vendim oficeri i policisë gjyqësore nuk kishte kryer detyrat e urdhëruara sipas urdhrit të datës 15.1.2020, në faqen nr. *** të fashikullit, por për shkak edhe të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 rezulton se veprimet e urdhëruara nuk janë kryer. Pavarësisht këtij fakti, subjekti ka interpretuar dhe mban qëndrimin se në zgjatjen për herë të parë të afatit të hetimeve nuk kërkohet që të identifikohet rasti i hetimit kompleks apo pamundësisë objektive. Ndërkohë rezulton që ky vendim të jetë marrë pas 3 muajsh nga data e regjistrimit të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale (15.1.2020), sipas afatit të parashikuar në nenin 323/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Më tej, subjekti ka informuar se me vendimin nr. ***, datë 11.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur: *“Pranimi i kërkesës. Miratimi i pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 12.2.2019, të regjistruar për veprën penale ‘shpërdorim i detyrës’, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”*. Ndaj këtij vendimi gjyqësor rezulton se ka paraqitur ankim kallëzuesi/viktima e veprës penale, z. M. Xh., dhe dosja është dërguar për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë përmes shkresës nr. *** Akti, datë 17.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për të mbështetur sqarimet e tij subjekti ka paraqitur si provë: (i) vendimin penal nr. ***, datë 11.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes të cilit është pushuar procedimi penal nr. ***, datë 12.2.2019, regjistruar për veprën penale “shpërdorim i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; (ii) shkresën nr. *** Akti, datë 17.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes së cilës është dërguar dosja e mësipërme në Gjykatën e Apelit Vlorë.

49.2. Arsyetim ligjor, bazuar në analizën e parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me kohëzgjatjen e hetimeve vlerësohet i bazuar pretendimi i subjektit, sipas të cilit, shkak për këtë ka qenë situata e pandemisë nga Covid-19, pasi periudha e kryerjes së hetimeve gjatë vitit 2020 përkon me nisjen dhe vazhdimin e pandemisë, kohë gjatë së cilës, veprimet hetimore të institucionit të prokurorisë kanë qenë të kufizuara.

Sa i takon ngarkesës në punë të subjektit për vitin 2019, pas verifikimit të analizës vjetore të vitit 2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilën është e pasqyruar

ngarkesa e punës gjatë vitit 2019, të paraqitur nga subjekti, vërehet se ai ka pasur gjithsej për trajtim 157 procedime penale dhe kanë përfunduar në gjykim prej tij 15 procedime. Krahasuar prokurorëve të tjerë të kësaj prokurorie, subjekti ka shqyrtuar një numër mesatar çështjesh.

Në lidhje me njoftimin e vendimeve të zgjatjes së afatit të hetimit, subjekti ka vërtetuar njoftimin e tyre përmes shërbimit postar, kallëzuesit/viktimës së veprës penale, përkatësisht shkresës nr. *** prot., (A. K.) datë 14.4.2020 dhe shkresës nr. *** prot., (A. K.) datë 20.7.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ndërkohë, për sa pretendohet nga subjekti se zgjatja për herë të parë e hetimeve nuk kërkon që të identifikohet rasti i hetimit kompleks apo pamundësisë objektive, vlerësohet se nuk qëndron pasi në nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale, sanksionuar se: *“1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme ky afat është deri në gjashtë muaj. 2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vjet. Tej afatit 2-vjeçar, për raste të akuzave për krim të organizuar dhe për krime që gjykohen me trup gjykues, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit. 3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve jepet i arsyetuar dhe u njoftohet të pandehurit dhe viktimës. 4. Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren”*.

Nga interpretimi i kësaj dispozite, pika 1 e saj vërtetë i jep mundësinë prokurorit për të zgjatur afatin e hetimit deri në tre muaj, por kjo nuk nënkupton mosarsyetimin e tij mbi arsyet e shtyrjes dhe pamundësinë e përfundimit të hetimit brenda afatit fillestar, sepse shtyrje të këtij lloji do të rrezikonin të ktheheshin në abuzive dhe do të sillnin zvarritje të afatit të hetimeve. Për këtë arsye ligjvënësi e ka kushtëzuar çdo shtyrje përtej afatit 3-mujor kompleksitetin e çështjes apo pamundësinë objektive për kryerjen e veprimeve brenda afatit të parashikuar. Ndërsa, dy vendimet e tjera të zgjatjes së afatit të hetimeve me argumentin se nuk është administruar vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe. më pas. hetimet janë mbyllur ende pa u administruar ky vendim, vlerësohen të pajustificuara dhe që kanë sjellë zvarritje të hetimit.

Sa i takon vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit për pushimin e çështjes, rezulton se kjo vendimmarrje është bërë objekt gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe është gjetur e drejtë, ndërkohë që është në pritje të shqyrtimit në shkallë të dytë.

49.3. Në konkluzion të të gjithë sa është arsyetuar më sipër, konstatohet se në këtë çështje ka pasur zvarritje të hetimeve nga subjekti i rivlerësimit, por duke iu referuar faktit që një shkak objektiv në tejkalimin e afateve ka qenë situata e pandemisë nga Covid-19 dhe në konsideratë të faktit se kjo nuk është një shkelje e përsëritur nga subjekti, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias⁵⁵ dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁵⁶, të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve

⁵⁵Shihni opinionin *** të Komisionit të Venecias.

⁵⁶Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, Komisioni vlerësoi që problematika e kësaj çështjeje është e pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me mangësi profesionale sipas germës “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016.

50. Denoncuesi V.R.⁵⁷, në denoncimin e tij, ngre pretendime se prokurori Albert Kuliçi, në çështjen penale nr. ***, të vitit 2015, për të cilën ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga prokuroria më e lartë (në rastin konkret Prokuroria e Përgjithshme) dhe gjykata, si dhe ka dalë në mbrojtje të të kallëzuarit. Me qëllim verifikimit e pretendimeve të denoncuesit, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dosjen e procedimit penal nr. ***⁵⁸. Pasi u shqyrtuan dhe analizuan të gjitha veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti për këtë çështje, rezultoi se pretendimet e denoncuesit për moszbatim të detyrave të caktuara nga prokurori më i lartë, nga subjekti i rivlerësimit Albert Kuliçi nuk qëndrojnë, pasi prej tij janë kryer dhe ezauruar veprimet hetimore të lëna si detyra nga Prokuroria e Përgjithshme. Ndërkaq, veprimtaria hetimore e prokurorit dhe vendimmarrja e tij i është nënshtruar dy herë shqyrtimit gjyqësor, dhe është lënë në fuqi, ndërkohë që është rrëzuar kërkesa e denoncuesit V. Rr.. Gjithashtu, nuk u evidentuan veprime apo mosveprime të subjektit në mbrojtje të të kallëzuarit, sikurse denoncuesi pretendonte.

51. Denoncuesi J. Th. B.⁵⁹ ngre pretendime për shpërdorim detyre nga prokurori Albert Kuliçi, pasi sipas tij, ai nuk ka kryer hetime në kuadër të procedimit penal që i përket çështjes së tij, pasi edhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 21.2.2018, ka vendosur vazhdimin e hetimeve dhe deri në datën 15.1.2019, nuk ka pasur asnjë informacion lidhur me ecurinë e këtij procedimit penal. Denoncuesi ka paraqitur bashkëngjitur denoncimit: (i) vendimin për mosfillimin e procedimit penal të datës 25.9.2017, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr. ***, i vitit 2017; (ii) vendimin nr. ***, datë 21.2.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila e ka prishur vendimin e prokurorisë së datës 25.9.2017, duke vendosur vazhdimin e hetimeve.

Me qëllim verifikimit e pretendimeve të denoncuesit Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë iu kërkua dosja e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, përfunduar me vendimin për mosfillimin e procedimit penal të datës 25.9.2017, e cila informoi se⁶⁰ kallëzimi penal nr. *** është në hetim nga prokurori Albert Kuliçi, pasi pas vendimit nr. ***, datë 21.2.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit të datës 25.9.2017 dhe vazhdimin e hetimeve, në datën 30.4.2018 është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal po nga ky prokuror. Pra, siç vërehet, çështja objekt denoncimi është në hetim e sipër nga subjekti i rivlerësimit dhe, si e tillë, del jashtë tagrit të vlerësimit nga Komisioni.

⁵⁷Shihni denoncimet nga shtetasi V. R., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 27.5.2019, dhe nr. *** prot., datë 20.11.2017, në dosjen e Komisionit.

⁵⁸Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

⁵⁹Shihni denoncimin nga shtetasi J. Th. B., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 21.1.2015, në dosjen e Komisionit.

⁶⁰Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

52. Denoncuesi A. H.⁶¹ pretendon se është dënuar me dy vjet burgim nga prokurori Albert Kuliçi në mungesë të provave. Po ashtu, denoncuesi pretendon se subjekti Albert Kuliçi ka miqësi me shtetasin A. J., i dënuar në Belgjikë për prostitucion.

52.1. Në lidhje me pretendimin e parë për vendimmarrje të gabuar, në zbatim të nenit 73 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se është jashtë tagrit të Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit, themelin e çështjes apo të vlerësojë interpretimin ose logjikën e prokurorit.

52.2. Me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit mbi njohjen dhe lidhjen me shtetasin A. J., gjatë hetimit administrativ u kryen veprimet si vijojnë:

- Subjektit iu kërkuan sqarime mbi njohjen dhe marrëdhënien me këtë shtetas, i cili deklaroi⁶² se nuk njeh njeri më këtë emër.

- Nga verifikimi në sistemin e Gjendjes Civile në vitin 2014 rezulton vetëm një shtetas me gjeneralitetet A. F. J., i datëlindjes 2.5.1966, me vendlindje Vlorë.

- SPAK-u⁶³ nuk ka konfirmuar procedime penale për përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar ose procedime pasurore në emër të shtetasit A. J..

- Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Policinë e Shtetit iu kërkua informacion, i cili nuk ka dhënë informacion, por njofton se i ka kërkuar të dhëna INTERPOL-it.

Me shkresën konfidenciale të datës 22.7.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka informuar se nga verifikimet në sistemin e kërkimit të INTERPOL-it nuk rezultojnë të dhëna për këtë shtetas deri në datën 22.7.2021.

Bazuar në sa më sipër, pretendimet e denoncuesit sa i takon shtetasit A. J. nuk u vërtetuan.

53. Denoncuesja D. M. M.⁶⁴ denoncon prokurorin Albert Kuliçi dhe gjyqtarin A. S.. Për prokurorin Albert Kuliçi ngre pretendime për proces jo të rregullt hetimor dhe moskryerje deri në fund të hetimit në çështjen që i përket shtetasit F. A., për të cilën ai ka vendosur pushimin e çështjes penale. Sipas saj, në lidhje me kallëzimin e paraqitur prej shtetasit F. A., në vitin 2015 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, janë dërguar për gjykim jo fajtorët e vërtetë, por vetëm njerëzit që janë përdorur për t'i kryer këto abuzime dhe se nga kjo prokurori nuk janë vlerësuar drejt të gjitha provat.

53.1. Me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncueses, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dosjen e procedimit penal nr. ***⁶⁵, nga aktet e së cilës u konstatua se:

- Shtetasi F. A. ka paraqitur në datën 28.2.2017 një kallëzim ndaj shtetasit B. A., të cilin e kishte caktuar si avokatin e tij, duke pretenduar se e ka mashtruar duke i vjedhur/përvetësuar pa të drejtë

⁶¹Shihni denoncimin nga shtetasi A. H., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 6.4.2018, në dosjen e Komisionit.

⁶²Shihni përgjigjet e subjektit dërguar në rrugë elektronike në datën 25.6.2021, në dosjen e Komisionit.

⁶³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.7.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁶⁴Shihni denoncimin nga shtetasja D. M., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 20.2.2018, në dosjen e Komisionit.

⁶⁵Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 29.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

shumën prej 6.150 euro si shpërblim për shërbimet e kryera ndaj tij në çështjen gjyqësore për pjesëtimin e një pasurie të paluajtshme.

- Në zbatim të urdhrin për kryerjen e veprimeve verifikuese të datës 1.3.2017 janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: është administruar dosja gjyqësore civile që i përket palëve F. A. paditës dhe të paditurit K. A. etj.; është administruar dokumentacioni i pasurisë objekt gjykimi nga ZVRPP-ja Vlorë; janë administruar dokumentet e paraqitura nga shtetasi B. A.; është pyetur në cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale i kallëzuar B. A..

- Me urdhrin e datës 11.4.2017, prokurori Albert Kuliçi ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit F. A. për veprën penale të mashtrimit.

- Në zbatim të urdhrin të datës 11.4.2017, nga prokurori janë kryer veprimet hetimore: datë 11.4.2017 është kërkuar informacion nga “Raiffeisen Bank” mbi transaksionet e kryera nga shtetasi B. A. në llogarinë e tij bankare; datë 11.4.2017 është kërkuar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë libri i shitjes i muajit dhjetor të vitit 2016, verifikimi nëse fatura tatimore e shitjes nr. ***, datë 1.12.2016, është përdorur dy herë nga subjekti “T.”, si dhe informacion nëse shtetasi B. A. ka qenë i punësuar pranë këtij subjekti për vitin 2016; datë 3.7.2017 janë kërkuar deklaratat tatimore të vitit 2016 të shtetasit B. A.; datë 18.5.2017 është sekuestruar fatura tatimore e shitjes nr. ***, datë 1.12.2016.

- Me vendimin e datës 28.6.2017, prokurori Albert Kuliçi ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, të regjistruar për veprën penale “mashtrim”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal.

Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza e akteve të dosjes së procedimit penal duket se: (i) nuk janë kryer veprime të plota hetimore sipas urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore të datës 11.4.2017, konkretisht, nuk rezulton të jenë pyetur në lidhje me rrethanat e hetimit shtetasit N. K. dhe E. V.; (ii) nuk është thirrur dhe nuk është pyetur kallëzuesi F. A.. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

53.2. Subjekti, në parashtrimet lidhur me këto konstatime, ka dhënë sqarimet si vijojnë:

Së pari, në lidhje me konstatimin e parë “*nuk janë kryer veprime të plota hetimore sipas urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore të datës 11.4.2017, konkretisht nuk rezulton të jenë pyetur në lidhje me rrethanat e hetimit shtetasit N. K. dhe E. V.*”, subjekti deklaroi se qëndron, duke sqaruar se e vetmja arsye se përse nuk janë pyetur dy shtetasit e mësipërm ka të bëjë me faktin se në krye të hetimit është identifikuar nevoja për pyetjen e tyre, por gjatë hetimit dhe, konkretisht, administrimit të provave shkresore ka rezultuar se fakti i kallëzuar nuk përbënte vepër penale.

Së dyti, në lidhje me konstatimin se përse nuk është pyetur z. F. A., i cili është subjekti kallëzues, subjekti ka sqaruar se nga dinamika e hetimit ka rezultuar se ka qenë krejtësisht e panevojshme pyetja e kallëzuesit për faktin se referuar provave shkresore dilte qartë se fakti i kallëzuar nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

Më tej, subjekti ka informuar se ndaj vendimit të pushimit të çështjes në lidhje me procedimin penal nr. ***, të vitit 2017, ka paraqitur ankim z. F. A. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me vendimin nr. ***, datë 11.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur rrëzimi i ankimit të çështjes nr. *** regj., që i përket ankuesit F. A. me objekt kundër vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim z. F. A. në Gjykatën e Apelit Vlorë. Me vendimin nr. ***, datë 3.5.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 11.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur si provë: (i) vendimin penal nr. ***, datë 11.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes të cilit është rrëzuar ankimi i paraqitur nga z. F. A. ndaj vendimit të pushimit për procedimin penal nr. ***, të vitit 2017; vendimin penal nr. ***, datë 3.5.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, përmes të cilit është lënë në fuqi vendimi nr. ***, datë 11.12.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

53.3. Në analizë të parashtrimeve të tij vërehet se subjekti ka mbajtur qëndrim reflektues, duke pranuar dhe argumentuar mosveprimin për pyetjen e tre shtetasve, në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata. Pavarësisht këtij qëndrimi, Komisioni vlerëson se urdhërimi i gjykatës për çështje të kësaj natyre është i detyrueshëm për prokurorin dhe tregon mosrespektim të autoritetit gjyqësor. Por, Komisioni nuk e çmoi këtë mosveprim si shkak për penalizim të subjektit, jo vetëm për faktin se është një rast i vetëm i pa përsëritur, por edhe në konsideratë të faktit se vendimmarrja e tij për pushimin e këtij procedimi penal është bërë objekt i gjykimit nga dy shkallë të gjyqësorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë, të cilat e kanë gjetur të drejtë këtë vendimmarrje, pa evidentuar shkelje.

54. Në artikullin e publikuar në media në linkun [/eskluziveja-prokurori-qe-fqvorizon-biznesmenin-helidon-gjikoka/](#) ngrihen pretendime se kallëzimi penal i shtetasit I. K. ndaj biznesmenit H. Gj., i kallëzuar për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, për trajtimin e së cilës është caktuar subjekti i rivlerësimit Albert Kuliçi, “fle” prej 2 vjetësh në Prokurorinë e Rrethit Vlorë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime duke vërtetuar nëse është ai prokurori që ndjek çështjen, si dhe të japë shpjegime mbi pretendimin për kohëzgjatjen e hetimeve prej 2 vjetësh, duke paraqitur dokumente nga dosja penale si urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, vendime për zgjatje hetimesh, veprimet hetimore të kryera dhe vendimmarrjen përfundimtare në lidhje me këtë çështje.

54.1. Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se në regjistrin e njoftimit të veprave penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë të pasqyruar 2 procedime penale me kallëzues z. I. K. dhe të kallëzuar z. H. Gj., etj. Sipas tij ai ka pasur në hetim vetëm procedimin penal nr. ***, datë 23.9.2019, të regjistruar për veprat penale “falsifikim të dokumenteve”, “shpërdorim të detyrës” dhe “veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, të parashikuara nga nenet 186, 248 dhe 301 të Kodit Penal. Hetimi ka zgjatur afërsisht 1 vit e 8 (tetë) muaj për shkak se hetimi ka qenë kompleks, me veprime hetimore që kërkojnë kohë, si në gjetjen dhe sekuestrimin e dokumenteve modele të lira krahasuese, ashtu edhe në administrimin e tabulateve telefonike dhe kryerjen e këqyrjes dhe analizimit të tyre. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se gjatë vitit 2020 ka qenë pezulluar për një kohë të gjatë edhe veprimtaria në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për shkak të pandemisë Covid-19, parë edhe nga treguesit e punës së prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Subjekti, për të vërtetuar pretendimet e tij, ka paraqitur: (i) fashikullin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2019, 8 (tetë) fashikuj; (ii) udhëzimin e përgjithshëm nr. ***, datë 10.3.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga Covid-19”; (iii) udhëzimin e përgjithshëm nr. ***, datë 19.3.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për disa masa procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes Covid-19”; (iv) udhëzimin e përgjithshëm nr. ***, datë 24.3.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga Covid-19”; (v) udhëzimin e përgjithshëm nr. ***, datë 8.4.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga Covid-19”; (vi) Udhëzimin e përgjithshëm nr. ***, datë 27.4.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për masat procedurale dhe administrative në veprimtarinë funksionale dhe mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të kufizimit të përhapjes së Covid-19”; (vii) urdhrin nr. ***, datë 16.2.2021, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë “Për marrjen e masave kundër Covid-19”.

54.2. Nga verifikimi i akteve të procedimit penal konstatohet se: (i) hetimi i këtij procedimi penal ka zgjatuar afërsisht 1 vit e 8 muaj; (ii) hetimi i këtij procedimi penal nga data e regjistrimit të emrit të personave 27.4.2021 deri në përfundimin e hetimeve 2.6.2021 ka zgjatuar 1 muaj e 5 ditë, pra, brenda afatit 3-mujor të parashikuar nga neni 323/2 i Kodit të Procedurës Penale; (iii) nuk ka pasur vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve, pasi emri i personave që u atribuohet kryerja e veprave penale është regjistruar më 24.4.2021 dhe hetimi për këtë procedim penal ka përfunduar më 2.6.2021, pra brenda afatit 3-mujor të parashikuar nga neni 323/2 i Kodit të Procedurës Penale; (iv) janë kryer veprime hetimore komplekse, kryerja e të cilave merr kohë të konsiderueshme, si 3 aktekspertime grafike nënshkrimesh dhe dokumentesh dhe 1 aktekspertim teknik, si dhe janë sekuestruar një numër i konsiderueshëm dokumentesh dhe tabulatesh telefonie; (v) hetimi i këtij procedimi penal është shtrirë gjatë gjithë vitit 2020, vit që përkon me situatën e pandemisë Covid-19 në vend, ku për institucionin e prokurorisë janë marrë masa për kufizimin e veprimeve hetimore sipas udhëzimeve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga krahasimi i treguesve të punës së prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë konstatohet se të gjithë prokurorët për vitin 2020 kanë një performancë më të ulët në raport me vitin 2019, për shkak të pandemisë Covid-19.

Në konkluzion të sa më sipër, vlerësohet se kohëzgjatja e hetimit të kësaj çështjeje nuk ka qenë në tejkallim të afateve procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe, për më tepër, ka qenë e diktuar nga kryerja e veprimeve hetimore që kërkojnë kohë edhe për shkak të situatës së pandemisë Covid-19.

Informacioni i marrë nga burimet arkivore

55. Gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni është bazuar edhe në informacionin e marrë nga burimet arkivore sipas të cilave: (i) ndaj prokurorit Albert Kuliçi nuk

janë marrë masa disiplinore; (ii) ka pasur 6 kallëzime penale të viteve 2014, 2015, 2017 dhe 2018, të cilat janë trajtuar nga prokuroritë kompetente dhe, në përfundim, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, si dhe 4 praktikë ankesa të trajtuara nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila ka orientuar ankuesit sipas rastit se ligjshmëria e vendimeve të pushimit shqyrtohej nga gjykata ose nëse kanë fakte për kryerje të veprave penale të paraqisnin kallëzime penale. Për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016 ka marrë vlerësimin “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore nuk kanë rezultuar problematika që do të bënin të domosdoshme kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, si dhe elementë që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

56. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se: (i) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016; (iv) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

57. Në datën 7.10. 2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Albert Kuliçi, në përfundim të së cilës, ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Albert Kuliçi dhe shpalli vendimin në seancën e datës 11.10.2021, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

58. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore. Në të gjitha komunikimet subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha

pyetjeve, duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar e duke paraqitur në dokumente shkresore për të vërtetuar pretendimet e tij, sidomos në lidhje me pasurinë e marrë në huapërdorje nga shtetasi P. B., edhe pse kjo pasuri ishte përfituar nga huadhënesi në një periudhë kur subjekti nuk ka qenë në detyrë. Gjithashtu, Komisioni konstatoi se subjekti ka mbajtur një qëndrim reflektues në parashtrimet e veta në lidhje me konstatimet për vlerësimin e aftësive profesionale, duke dhënë shpjegime të detajuara dhe dokumente shkresore duke argumentuar në çdo rast shkaqet e veprimeve apo mosveprimeve të tij. Gatishmëria dhe qëndrimi bashkëpunues gjatë gjithë procesit janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

VI. KONKLuzion Përfundimtar

59. Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Albert Kuliçi ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Albert Kuliçi ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Albert Kuliçi ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Albert Kuliçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 11.10.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi